



Pranuar / Dorëzuar Prilimjenal/Prodato Received/Delivory	27-06-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Hr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTICK	3755/2022		115

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.441/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.441/2022 të datës 06.05.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ përmes avokatit \_\_\_\_\_ me adresë,

\_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike” kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I.SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.ref:201/2022 i datës 08.04.2022 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II.OBLIGOHET Zëvendës Kryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta *rishqyrtuar* lëndën e ankueses

III.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në pozitën Zyrtare e lartë për Këshillin Evropian dhe Evropën Jugore sipas Akt emërimit të datës 23.12.2013, me Vendimin më numër ref.636/2018 të datës 23.07.2018 të Zëvendëskryeministrit të parë /Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), i jepet grada diplomatike Ministër Këshilltar dhe caktohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër /Mbretëria e Bashkuar me mandat katër (4) vjeçar, duke filluar nga data 01.10.2018.





Me notën verbale të datës 13.01.2020 me nr.ref. 10/të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, njoftohet Protokollit Shtetit për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar se do shërbej si e ngarkuar me punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar.

Më tutje, ankuesja me Vendimin me numër ref.26/2021, të datës 16.04.2021, të Ministres të MPJD-së, ankuesja me gradën Ministër -Këshilltare emërohet e ngarkuar me punë të përkohshme, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër.

Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 08.04.2022 merr Vendim me numër Nr.Ref.201/2022, sipas të cilit ankuesen me gradën diplomatike Ministër Këshilltare, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar e kthen/tërheq nga misioni diplomatik nga data 30.04.2022.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin e Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me numër Nr.ref:201/2022, të datës 08.04.2022 lidhur me tërheqjen dhe kthimin e saj nga Ambada e Republikës së Kosovës në Londër/ Mbretërinë e Bashkuar, me datën 06.05.2022 përmes përfaqësuesit të saj, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2641/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 19.05.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 26.05.2022, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 15.06.2022 ka nxjerr vendimin VK.nr.58/2022 për shtyrje të afatit edhe për 10 (dhjetë) ditë pune të ankesës A.nr.441/2022 të datës 06.05.2022.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e ankueses me numër të protokollit 2641/2022 e datës 06.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 23.12.2013; Vendimi me nr.ref.636/2018 i datës 23.07.2018 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Nota Verbale Ref.ZDP 10/2020 me nr.protokollit 60/2020 i datës 30.01.2020; ; Vendimi me nr.ref.26/2021 i datës 16.04.2021 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; ; Vendimi me nr.ref.201/2022 i datës 08.04.2022 i Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Autorizimi i datës 04.05.2022; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 3053/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/28; Flet kthesë e datës 19.05.2022; Vendimi i datës 23.11.2019 me nr.44/09; Vendimi i datës 23.08.2013; Vendimi i datës 20.12.2013 me nr. ZSP/288/13 ; Vendimi i datës 11.05.2022 me nr. ref 152/2022 dhe Vendimi VK.nr.58/2022 i datës 15.06.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankueses të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* duke e obliguar Zëvendës Kryeministren dhe Ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë rishqyrtimin e



Vendimit me numër Nr.ref:201/2022 i datës 08.04.2022 përmes të cilit ankuesja është kthyer/tërhequr nga misioni diplomatik ,SEPSE :

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.ref:201/2022 i datës 08.04.2022 ,është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm e plotësuar dhe ndryshuar me rregulloren (QRK) Nr.04/2014 dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 08.04.2022 ka nxjerr Vendim me numër Nr.ref.201/2022 përmes të cilit, *ne gradën diplomatike Ministër Këshilltare në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Mbretërinë e Bashkuar e kthen/tërheq nga misioni diplomatik ne Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës*, ndërsa ne paragrafin II të këtij vendimi citoj „ *Kthimi i shprehur si në piken e 1 të këtij vendimi behet me datën 30.04.2022*” andaj Kolegji vlerëson se Zëvendës Kryeministria dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka arritur të arsyetojë vendimin siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: *“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret”*,poashtu nuk ka arritur të sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i atakuar përmes kësaj ankese, respektivisht të sqarojë në mënyrë të hollësishme shkaqet se për çfarë arsye behet kthimi i ankueses nga misioni diplomatik ne Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, po ashtu nuk ka arritur të arsyetojë Vendimin në fjalë sepse në rastin konkret kanë qenë të pazbatueshme dispozitat e nenit 23 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsyesimit të pamjaftueshëm të Vendimit numër Nr.ref.201/2022 nga ana Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është e barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Kolegji për Shqyrtimin Dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.ref.201/2022 i datës 08.04.2022, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1,1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafin 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike si dhe nuk përmban, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)”, siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës të sjella nga ankuesja dhe organi i punësimit nuk kemi asnjë provë që dëshmon se ankuesja ka bërë shkelje ligjore siç është cekur në arsyetimin e vendimit se e njëjta ka shkelur nenin 23 paragrafin 1 pika



1.4 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës që është tërheqë/kthyer para afatit nga misioni. Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Ministria e Punëve të Jashtme me rastin e nxjerrjes së vendimit me nr.ref.201/2022 të datës 08.04.2022, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/-114 për Zyrarët Publikë dhe nenit 30 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës i cili përcakton se "Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm; 1.2. shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori i tyre i drejtpërdrejt; 1.3. shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin të Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit që kanë kryer këto shkelje".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Vendimi me numër Nr.ref:201/2022 i datës 08.04.2022 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave administrative është i kundërligjshëm siç e përcakton Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku thuhet se : "**Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative**", andaj, nisur nga konstatimi i mësipërm, Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin me numër Nr.ref.201/2022 të datës 08.04.2022 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe poashtu edhe për faktin se përmes këtij akti administrativë nuk është qartësuar çështje e vendimeve të mëparshme që kanë qenë në fuqi në lidhje me ankuesen dhe mbi këto arsye të specifikuara më lartë ekziston bazë e mjaftueshme ligjore që lënda e ankueses në lidhje me vendimin për tërheqjen/kthimin nga misioni diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të kthehet në rishqyrtim me qëllim të vendosjes konform legjislacionit në fuqi që rregullon këtë çështje.


Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë, gjegjësisht Ministria e Punëve të Jashtme e cila në procedurë të rishqyrtimit duhet t'i marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.441/2022, datë 27.06.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses,
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

